



Në përputhje me autorizimin e dhënë sipas Nenit 35, paragrafit 1, nënparagrafit 1.1 dhe nenit 25 të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Bordi i Bankës Qendrore, në mbledhjen e mbajtur më 5 prill 2012, miratoi

Rregullore për Regjistrin e Poseduesve të Llogarive Bankare

KAPITULLI 1 Dispozitat e përgjithshme

Neni 1 Qëllimi

1. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Banka Qendrore) themelon Regjistrin e Poseduesve të Llogarive Bankare në Kosovë, me qëllim të ngritjes dhe avansimit të sistemit të pagesave, përmirësimit të cilësisë së transaksioneve dhe mbikëqyrjes të aktivitetit të bankave komerciale nga Banka Qendrore.
2. Kjo Rregullore përcakton mbledhjen, përpunimin dhe shfrytëzimin e informatave për poseduesit e llogarive bankare përmes Regjistrit të Poseduesve të Llogarive Bankare. Raportimi i informatave për llogaritë bankare (të hapura/mbajtura pranë bankave komerciale edhe para nxjerrjes së kësaj rregulloreje), do të jetë e obligueshme për të gjitha bankat komerciale që janë të licencuara nga Banka Qendrore.

Neni 2 Fushëveprimi

Kjo Rregullore aplikohet për të gjitha bankat komerciale që veprojnë në Kosovë dhe që janë të licencuara nga Banka Qendrore.

Neni 3 Përkufizimet

Përkufizimet për qëllim të kësaj Rregulloreje do të kenë kuptimet si në vijim:

1. “*regjistri i poseduesve të llogarive bankare*” nënkupton bazën e të dhënave të krijuar në kuadër të Bankës Qendrore e cila përmban të gjitha informatat për poseduesit e llogarive bankare në bankat komerciale që veprojnë në Kosovë.

2. “*posedues i llogarisë*” nënkupton personin fizik apo juridik që është klient i bankave komerciale dhe i cili ka hapur llogari bankare në bankën përkatëse.
3. “*ofruer i shënimeve për llogaritë*” nënkupton institucionin financiar i licencuar si bankë komerciale nga Banka Qendrore.
4. “*subjekt i të dhënave*” i referohet personit për të cilin janë mbledhur informatat e llogarisë/llogarive bankare dhe janë përpiluar në Regjistrin e Poseduesve të Llogarive Bankare. Subjektet e të dhënave përfshijnë personat fizik dhe juridik të cilët kanë llogaritë bankare në ndonjërin nga bankat komerciale që veprojnë në Kosovë, të dhënat dhe informatat e të cilëve mblidhen në Regjistrin e Poseduesve të Llogarive Bankare dhe janë në dispozicion sipas kësaj Rregulloreje.
5. “*raporti për llogarinë bankare*” nënkupton çdo komunikim në formë të shkruar ose elektronike e çdo informate që bëhet nga Regjistri i Poseduesve të Llogarive Bankare.
6. “*person juridik*” është shprehje e përgjithshme që nënkupton çdo subjekt, përfshirë edhe shoqërinë tregtare, organizatën joqeveritare, e cila ka identitet ligjor të veçantë dhe të ndryshëm nga anëtarët, pronarët apo aksionarët e saj.
7. “*person*” nënkupton dhe i referohet vetëm një personi fizik.
8. “*të dhëna personale*” nënkupton çdo informatë që ka të bëjë me një person fizik të identifikuar.
9. “*të dhëna të ndjeshme personale*” nënkupton çdo informacion personal që zbulon origjinën racore ose etnike, mendimet politike ose filozofike, besimet fetare, anëtarësimin në sindikata, gjendjen shëndetësore, orientimin seksual, karakteristikat biometrike, ose gjendjen penale apo të kundërvajtjeve.
10. “*udhëzim*” nënkupton rekomandimin me shkrim të lëshuar nga Banka Qendrore i cili ka një aplikim të përgjithshëm dhe është i obligueshëm në tërësinë e tij dhe është drejtpërdrejtë i aplikueshëm.

KAPITULLI 2

Regjistri i Poseduesve të Llogarive Bankare

Neni 4

Fusha e zbatimit

1. Qëllimi i Regjistrimit të Poseduesve të Llogarive Bankare është grumbullimi dhe shpërndaja e informatave për numrin e llogarisë së subjekteve, si dhe të dhënat personale të tyre përfshirë edhe emrat, numrin personal ose numrin e regjistrimit të biznesit, adresën apo vendbanimin e subjekteve të të dhënave.
2. Banka Qendrore mund të lëshojë një udhëzim për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

KAPITULLI 3

Grumbullimi e informatave për poseduesit e llogarive bankare

Neni 5

Grumbullimi i lejuar dhe i ndaluar i informatave për poseduesit e llogarive bankare

1. *Grumbullimi i lejueshme i informatave.* Në pajtim me këtë Rregullore, në Regjistrin e Poseduesve të Llogarive Bankare do të grumbullohen dhe mirëmbahen të dhënat për poseduesit e llogarive bankare, së paku për sa vijon:
 - a. Numrin e llogarisë bankare të çdo klienti i cili ka hapur llogari bankare në ndonjërin prej bankave komerciale të licencuara dhe që veprojnë në Kosovë duke përfshirë datën e hapjes dhe statusin (aktiv, pasiv, bllokuar, mbyllur, etj.) e llogarisë;
 - b. Informata të përgjithshme identifikuese përfshirë emrin e plotë të personit fizik dhe/apo personit juridik, numrin personal, vendin dhe datën e lindjes ose regjistrimit dhe adresën;
2. *Grumbullimi i informatave të ndaluara.* Regjistri i Poseduesve të Llogarive Bankare nuk do të mbledh, mbaj apo raportojë asnjë nga informata në vijim për subjektin:
 - a. Gjendjen e llogarisë dhe depozitave në llogari apo në llogaritë bankare; dhe
 - b. Të dhënat e ndjeshme personale, siç parashihet në Ligjin për Mbrojtjen e të dhënave personale .

Neni 6

Raportimi i informatave për poseduesit e llogarive bankare

1. *Kërkesa për të raportuar.* Nga të gjithë ofruesit të llogarive bankare kërkohet që të raportojnë në Regjistrin e Poseduesve të Llogarive Bankare të gjitha informatat e përcaktuara në nenin 5 të kësaj Rregulloreje.
2. *Standardi i raportimit.* Ofruesit e të dhënave për poseduesit e llogarive bankare duhet të ofrojnë informata të sakta, me kohë dhe të plota për llogarinë bankare në Regjistrin të parashikuar sipas kësaj Rregulloreje apo ndonjë udhëzimi tjetër.
3. *Korrigjimi i të dhënave.* Nëse në ndonjë moment ofruesi i shënimeve për mbajtësin e llogarive bankare përcakton se informata e dhënë nuk është e plotë, me kohë ose e saktë, ofruesi i shënimeve të llogarisë bankare duhet të ndërmarrë të gjithë hapat për të siguruar informatat e plota, me kohë dhe të sakta dhe për t'ia parashtruar ato Regjistrit të Poseduesve të Llogarive Bankare.

KAPITULLI 4

Përdorimi i Regjistrit të Poseduesve të Llogarive Bankare

Neni 7
Qasja ne Regjistrin e Poseduesve të Llogarive Bankare

1. *Subjektet që do të kenë qasje në Regjistrin e Poseduesve të Llogarive Bankare.* Subjektet në vijim janë të lejuara që të kenë qasje të informatave për poseduesit e llogarive nga Regjistri i Poseduesve të Llogarive Bankare:
 - a. Këshilli Gjyqësor i Kosovës;
 - b. Institucionet apo subjektet e parapara me Ligjin për Procedurën Përmbartimore.

Neni 8
Përdorimi i Regjistrit të Poseduesve të Llogarive Bankare

1. *Përdorimi i lejueshëm i Regjistrit të Llogarive Bankare.*
Subjektet që lejohen të kenë qasje në informatat e Regjistrit të Llogarive Bankare janë të specifikuar në nenin 7. të kësaj Rregulloreje dhe do të përdorin informatat e llogarive bankare:
 - a. vetëm për qëllime për të cilat ato janë marrë dhe për asnjë qëllim tjetër; dhe
 - b. nuk do lejojnë shpërndarjen e informatave të llogarive bankare palëve të treta, përveç nëse e njëjta kërkohet me ligj apo me urdhër të një gjykate kompetente.

KAPITULLI 5
Të drejtat e subjekteve të të dhënave

Neni 9
Të drejtat e subjekteve

1. Subjektet e mbajnë të drejtën e tyre të privatësisë së të dhënave personale në pajtim me ligjin.
2. Subjektet do të kenë mundësi për të kërkuar informata nga ofruesit përkatës të të dhënave.
3. Ofruesit e shënimeve për llogarit do të ndërmarrin të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar që ata të jenë në gjendje të raportojnë si duhet informatat për subjektin e të dhënave për Regjistrin e Poseduesve të Llogarive Bankare.
4. Ofruesit e shënimeve për llogarit do t'ia raportojnë informatat për subjektin e të dhënave Regjistrin të Poseduesve të Llogarive Bankare brenda një dite të punës (24 orë) pas hapjes së një llogarie të re bankare ose pas ndërrimit të statusit (mbyllje, pasivizim, bllokim, etj.) së një llogarie ekzistuese të poseduesit të llogarisë bankare.
5. Subjektet e të dhënave kanë të drejtë të kontestojnë dhe kërkojnë përmirësimin, e informatave personale për llogarinë bankare nga ofruesit e të dhënave (emri, mbiemri, adresa, data e lindjes, numri personal, etj.)

6. Dispozita e këtij neni nuk e ndalon apo kufizon kërkesën për paraqitjen e informatave shtesë nga subjekti i të dhënave të përcaktuar me ndonjë ligj apo rregullore tjetër.

KAPITULLI 6

Ndëshkimet

Neni 10

Ndëshkimet për moszbatimin e Rregullores

Ofruesit e shënimeve të poseduesve të llogarive bankare që konstatohet se kanë shkelur këtë Rregullore do të jenë subjekt i ndëshkimeve administrative të specifikuara në Ligjin për Bankën Qendrore ose ndonjë ligj tjetër relevant. Shkeljet që mund të rezultojnë me ndëshkime administrative përfshijnë por nuk kufizohen në:

- a. dështimin për të raportuar informatat mbi mbajtësin e llogarisë bankare;
- b. raportimin e vonuar të informatave për mbajtësin e llogarisë bankare;
- c. raportimin e pasaktë të informatave për poseduesit e llogarisë bankare;
- d. raportimin e qëllimshëm të të dhënave të pasakta për mbajtësin e llogarisë bankare;
- e. keqpërdorimin e raporteve për poseduesit e llogarive bankare nga ana e ofruesve të shënimeve të llogarive bankare; dhe
- f. publikimi i paautorizuar i informatave konfidenciale për poseduesit e llogarive bankare;

KAPITULLI 7

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Neni 11

Dispozitat kalimtare

Për llogaritë të cilat janë hapur para hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore, ofruesit e shënimeve të poseduesve të llogarive bankare, janë të obliguar që të dhënat t'i bartin në regjistrin e poseduesve të llogarive bankare brenda 6 muajsh nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje.

Softueri i Regjistrin të Poseduesve të Llogarive Bankare do të jetë pronë e Bankës Qendrore.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 1 maj 2012.

Gazmend Luboteni
Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës